

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150, si dhe bazuar në nenin 4, paragrafi 3, dhe nenin 64, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2024 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT TË SIGURUESVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Rregullorja për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguruesve vendos standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga siguruesit, me qëllim që siguruesit të kenë asete të lira likuide të cilësisë së lartë që mund të shndërrohen lehtë dhe menjëherë në para të gatshme, për të përmbushur detyrimet e tyre në afat.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit dhe degët e sigurueseve të jashtëm që veprojnë në Republikën e Kosovës, të licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), të referuara në vijim me termin *sigurues*.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim siç janë përkufizuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: Ligji për Sigurimet) dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllime të kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Rreziku i likuiditetit** – nënkupton rrezikun kur siguruesi nuk është në gjendje t'i shfrytëzojë investimet dhe asetet tjera në mënyrë që t'i shlyejë obligimet financiare që arrijnë për pagesë.

Neni 3

Menaxhimi i likuiditetit

1. Siguruesit menaxhojnë burimet financiare dhe investimet e tyre në mënyrë të tillë që të sigurojnë në çdo kohë përmbushjen e detyrimeve, në afat.
2. Për këtë, siguruesit krijojnë një sistem për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim menaxhimin e mirë të rrezikut të likuiditetit të tyre, i cili është në përputhje me madhësinë e siguruesit, llojin e aktivitetit dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.
3. Bordi i Drejtorëve të sigurueseve dhe organet tjera kompetente të siguruesit ashtu siç është përcaktuar me këtë rregullore me qëllim mbrojtjen ndaj rrezikut të mungesës së likuiditetit, miratojnë akte të brendshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, të cilat përbëjnë sistemin për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit dhe përfshijnë:

- 3.1. Strategjinë, politikat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut likuiditetit që përcaktojnë metodat e menaxhimit të likuiditetit të siguruesve, në rrethana të zakonshme dhe të jashtëzakonshme;
- 3.2. Planifikimin e pritshëm dhe të mundshëm të rrjedhës së parasë;
- 3.3. Strukturën organizative për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
- 3.4. Sistemin e kontrollit të brendshëm;
- 3.5. Sistemin e përshtatshëm të menaxhimit të informacionit të përdorur për matjen, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e likuiditetit;
- 3.6. Planin e masave dhe procedurat për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të rrezikut të mungesës së likuiditetit.

Neni 4

Strategjia dhe politikat

1. Siguruesi duhet të hartoj strategji dhe politika për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
2. Strategjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet të përmbaj elementet minimale si në vijim:
 - 2.1. objektivat e strategjisë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
 - 2.2. parimet për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
 - 2.3. metodologjinë e përgjithshme që siguruesi zbaton për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në periudhat afatshkurta dhe afatgjata;
 - 2.4. metodologjinë e përgjithshme dhe vizionin e siguruesit për të hyrë në tregje dhe burime të financimit.
3. Strategjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit hartohet si një dokument i veçantë ose si një pjesë e planit strategjik të siguruesit. Strategjia duhet rishikohet në baza të rregullta, së paku 3 vjeçare.
4. Politika për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet të përmbaj elementet minimale si në vijim:
 - 4.1. identifikimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedhë nga produktet dhe operacionet e reja;
 - 4.2. matjen e rrezikut të likuiditetit, veçanërisht të:
 - 4.2.1. pozicionit aktual të likuiditetit, duke përfshirë vlerësimin e aseteve likuide;
 - 4.2.2. parashikimit të rrjedhës hyrëse dhe dalëse të parasë;
 - 4.2.3. përputhjes në mes të afatit të maturimit të fondeve në dispozicion dhe të burimeve të financimit;
 - 4.2.4. përcaktimit të treguesve të likuiditetit dhe përdorimin e tyre në procesin e monitorimit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit të siguruesit;
 - 4.2.5. vlerësimit periodik të ecurisë së tregjeve ku plotësohen nevojat për likuiditet.
5. Politika për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit hartohet si një dokument i veçantë i siguruesit. Kjo politikë duhet rishikohet në baza të rregullta, së paku vjeçare.

Neni 5
Planifikimi i rrjedhës së parasë

1. Siguruesi duhet të planifikojë rregullisht rrjedhën e pritshme, të njohur dhe /ose të mundshme të hyrjes dhe daljes së parave.
2. Për qëllim të monitorimit të likuiditetit, siguruesi planifikon rrjedhën e parasë për çdo muaj, në ditën e parë të punës të atij muaji, në baza ditore;
3. Siguruesi duhet ta ruaj dokumentacionin e planifikimit të rrjedhës së parasë, sipas këtij neni për së paku 5 (pesë) vite.

Neni 6
Struktura organizative për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit

1. Siguruesi duhet që në kuadër të strukturës së tij organizative të përcaktojnë në mënyrë të qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave qeverisëse të tij, të autorizuara për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
2. Bordi i Drejtorëve i siguruesit, në lidhje me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit është përgjegjës të:
 - 2.1. miratojë strategjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
 - 2.2. miratojë politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe të monitorojë zbatimin e tyre;
 - 2.3. shqyrtoj raportet e rrezikut të likuiditetit;
 - 2.4. monitorojë efikasitetin e kontrollit të brendshëm si pjesë integrale e sistemit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.
3. Komiteti i menaxhimit të rrezikut kërkohet të:
 - 3.1. monitorojë politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe të jap propozime për rishikimin e tyre;
 - 3.2. vlerësojë sistemin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
 - 3.3. analizojë raportet e rrezikut të likuiditetit dhe monitorojë menaxhimin e këtij rreziku;
 - 3.4. përcaktojë dhe periodikisht të rishikojë treguesit e brendshëm të likuiditetit.
4. Përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit të siguruesve, është edhe menaxhmenti i lartë, përfshirë funksionin e menaxhimit të rrezikut të siguruesit siç përcaktohet me Rregulloren për Qeverisjen Korporative të Siguruesve.

Neni 7
Sistemi i kontrollit të brendshëm

1. Siguruesi duhet të vendos procedurat e duhura të kontrollit të brendshëm për të siguruar integritetin e procesit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kuadër të procesit të menaxhimit të rrezikut të përgjithshëm. Kontrolli i brendshëm i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit është pjesë integrale e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm të siguruesit.
2. Për qëllime të kontrollit të brendshëm të ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit, siguruesi duhet të:

- 2.1. caktojë limitet e rrjedhës së parasë deri në shumat e caktuara dhe të monitorojë pajtueshmërinë me këto limite;
- 2.2. krijojë procese efektive të raportimit të mospajtueshmërive të mundshme me limitet e referuara në nënparagrafin 2.1 të këtij paragrafi;
- 2.3. verifikojë rregullisht të dhënat dhe informatat e përdorura gjatë llogaritjes së likuiditetit të siguruesit;
- 2.4. sigurojë përputhshmërinë me të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të BQK-së, si dhe rregullat e brendshme të siguruesit.

Neni 8

Sistemi i menaxhimit të informacionit

1. Siguruesi duhet të krijojë një sistem të menaxhimit të informacionit për të siguruar me kohë dhe në baza të vazhdueshme matjen, monitorimin, kontrollimin dhe raportimin e likuiditetit të siguruesit, me rastin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.
2. Sistemi i menaxhimit të informacionit kërkohet që së paku të:
 - 2.1. matë dhe monitorojë likuiditetin e siguruesit në baza ditore dhe në baza tjera kohore;
 - 2.2. monitoron pajtueshmërinë me nivelet e mbajtjes së normës së likuiditetit, të përcaktuara me nenin 11 të kësaj rregullore;
 - 2.3. sigurojë të dhëna për përcaktimin e treguesve të likuiditetit dhe përgatitjes së formave raportuese për nevojat e organeve të siguruesit.

Neni 9

Plani i masave dhe procedurat për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të rrezikut të mungesës së likuiditetit

1. Siguruesi duhet të hartojë planin e masave dhe procedurat për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve që mund të sjellin mungesë të likuiditetit. Siguruesi duhet të rishikojë këtë plan së paku në baza vjetore, me qëllim marrjen në konsideratë të ndryshimeve të mundshme të kushteve të brendshme dhe të jashtme të operacioneve. Kur e vlerëson të nevojshme, BQK rezervon të drejtën të kërkojë nga siguruesi testimin e planit.
2. Plani i masave dhe procedurat për parandalimin dhe eliminimin e shkaqeve të rrezikut të mungesës së likuiditetit janë pjesë e sistemit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe përmban:
 - 2.1. ndarje të qartë të detyrave, kompetencave, përgjegjësi dhe vendimmarrjes në lidhje me zbatimin e planit;
 - 2.2. treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjalizues për rrethanat e jashtëzakonshme si dhe përcaktimin e personave përgjegjës brenda siguruesit për monitorimin dhe raportimin e këtyre treguesve;
 - 2.3. kushtet në të cilat zbatohet plani;
 - 2.4. përcaktimin e veprimeve që duhet të ndërmerren, identifikimin e burimeve të mundshme të fondeve, nivelin e tyre dhe përparësitë në përdorim, si dhe përcaktimin e intervaleve kohore brenda të cilëve këto veprime duhet të ndërmerren;

Neni 10

Metoda e llogaritjes së normës së likuiditetit

1. Norma e likuiditetit është raporti midis asetëve likuide të siguruesit dhe detyrimeve të maturuara për pagesë plus detyrimeve që maturohen së shpejti.
2. Asetet likuide janë asetet në dispozicion të siguruesit, të cilat përbëhen nga:
 - 2.1. Paraja e gatshme në arkë;
 - 2.2. Paraja në llogaritë rrjedhëse në banka dhe institucione tjera financiare;
 - 2.3. Depozitat pa afate dhe depozitat tjera (përfshirë interesat nga këto depozita) në banka dhe institucione tjera financiare me maturitet të mbetur deri në 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike. Përfshirë nga kjo dispozitë bëjnë depozitat e sigurueseve për të plotësuar kërkesat e nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet dhe depozitat e lërë peng për kredi;
 - 2.4. Të arkëtueshmet në llogari të kliringut, të cilat duhet të paguhen brenda 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike;
 - 2.5. Pjesa e papërdorur e kredive bankare të aprovuara për siguruesin të cilat disponohen pa kushte brenda 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike;
 - 2.6. Letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, qeveritë qendrore dhe bankat qendrore të vendeve të huaja (përfshirë interesat nga këto letra me vlerë), të cilat mund të konvertohen në para të gatshme brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve kalendarike;
 - 2.7. Letrat me vlerë të tregtueshme në tregjet e rregulluara financiare (përfshirë interesat nga këto letra me vlerë), me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut, të barasvlerëshëm me vlerësimin e S&P jo më pak se AA- si dhe të cilat mund të konvertohen në para të gatshme brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve kalendarike.
 - 2.8. Letrat me vlerë të klasifikuar si të mbajtura deri në maturim që kanë afat maturimi deri në 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike.
3. Detyrimet e siguruesit të maturuara për pagesë janë detyrimet për kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, detyrimet për kontratat e risigurimit, detyrimet për komisionet, detyrimet që rrjedhin nga aktiviteti i investimeve, si edhe detyrimet tjera të cilat janë maturuar në ditën e llogaritjes së normës së likuiditetit.
4. Detyrimet e siguruesit që maturohen së shpejti janë detyrimet për kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, detyrimet për kontratat e risigurimit, detyrimet për komisionet, detyrimet që rrjedhin nga aktiviteti i investimeve, si edhe detyrimet tjera që kanë afat maturimi deri në 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike ose që mund të tërhiqen deri në 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita që llogaritet norma e likuiditetit.
5. Detyrimet e përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, gjithashtu përfshijnë zëra të bilancit dhe zëra jashtë bilancit, të cilat nuk mund të tërhiqen por janë të lidhura me shpenzime apo detyrime nga kontratat e ardhshme dhe garancitë e dhëna.
6. Detyrimet e përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4, të këtij neni, gjithashtu përfshijnë shpenzimet e shtyra që nuk paraqiten si detyrime në bilanc, por që pritet të maturohen (1) ditë pas ditës që llogaritet norma e likuiditetit, duke mbajtur parasysh detyrimin përkatës.

7. Për qëllim të llogaritjes së normës së likuiditetit, asetet likuide dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre duhet të pasqyrohen në vlerën kontabël.

Neni 11

Niveli i mbajtjes së normës së likuiditetit

1. Siguruesi konsiderohet likuid në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 10 të kësaj rregullore, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një) si koeficient apo 100 (njëqind) % si përqindje, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë rregullore.
2. Siguruesi konsiderohet jolikuid në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 10 të kësaj rregullore, është më i ulët se 1 (një) si koeficient apo 100 (njëqind) % si përqindje.
3. Në raste se norma e likuiditetit e siguruesit bie nën 1 (një) si koeficient apo 100 (njëqind) %, siguruesi brenda 5 ditëve të punës duhet të kthejë normën e likuiditetit në parametrat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 12

Evidentimi dhe monitorimi ditor

1. Siguruesi llogaritet sipas të dhënave ditore këto elementë:
 - 1.1. Vlerën e aseteve likuide të përcaktuara në paragrafin 2, të nenit 10 të kësaj rregullore;
 - 1.2. Nivelin e detyrimeve që janë maturuar sipas përcaktimeve të paragrafëve 3 deri 6 të nenit 10 të kësaj rregullore;
 - 1.3. Nivelin e normës së likuiditetit të përcaktuar në nenin 11 të kësaj rregullore.
2. Siguruesi në baza ditore duhet të llogarisë vlerën e aseteve likuide, nivelin e detyrimeve që janë maturuar dhe detyrimeve që maturohen së shpejti si dhe nivelin e normës së likuiditetit sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të këtij neni duke përdorur Formularin 1, të kësaj rregullore të cilin duhet ta ruaj në dokumentacionin e tij.
3. Të gjitha llogaritjet dhe raportimet sipas kësaj rregullore duhet të bëhen në Euro. Ndërsa në rast të ndodhjes së transaksioneve në valutën e huaj, këmbimi bëhet në valutën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga BQK-ja, në ditën e llogaritjes së normës së likuiditetit.

Neni 13

Njoftimi në rast mungese të likuiditetit

1. Në rast se evidentohet mungesë likuiditeti sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të nenit 11 të kësaj rregullore, siguruesi duhet të njoftojë BQK-në për këtë fakt, jo më vonë se 24 orë pasi është konstatuar mungesa e likuiditetit.
2. Njoftimi përfshinë shumën gjithsej të strukturës së aseteve likuide dhe detyrimet e maturuara dhe të papaguara të siguruesit, arsyet e paaftësisë për të kryer pagesat si dhe masat e planifikuara dhe të ndërmarra, me qëllim eliminimin e paaftësisë së përkohshme për të kryer pagesat ose eliminimin e shkaqeve të mungesës së likuiditetit.

3. Përveç siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, në njoftim siguruesi duhet të specifikojë në mënyrë të veçantë masat e ndërmarra ose detajet për burimin e aseteve që janë ose që përdoren për të eliminuar mungesën e likuiditetit, si dhe për rrjedhën monetare të pritshme dhe të mundshme për muajin e ardhshëm.
4. Përveç njoftimit, siguruesi duhet gjithashtu të dërgojë në BQK edhe përlllogaritjen e normës së likuiditetit sipas Shtojcës 1, për datën në të cilën është konstatuar mungesa e likuiditetit.
5. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është Shtojca 1 – Përlllogaritja e normës së likuiditetit.
6. Në kushte të situatave të vështirësive me likuiditet, siguruesi bashkëpunon ngushtë me BQK-në dhe shkëmben informacion të vazhdueshëm me të, mbi veprimet e ndërmarra për rikthimin e saj në parametra të përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 14

Afatet e njoftimit për normën e likuiditetit

1. Siguruesi duhet të njoftojnë BQK-në për normën e likuiditetit, asetet likuide dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre, për të gjitha ditët e punës së muajit të kaluar, jo më vonë se 15 ditë pune pas ditës së fundit të muajit për të cilin është përgatitur.
2. Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të bëhet në formë elektronike.

Neni 15

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet civile

1. Çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë rregullore për sa i përket likuiditetit të siguruesve dhe degëve të siguruesve, dispozitat e kësaj rregullore do të mbizotërojnë.
2. Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje është subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L -045 për Sigurimet.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 30 shtator 2024.

Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

SHTOJCA 1 – Përlllogaritja e normës së likuiditetit

Emri i Siguruesit

Viti

Data (dd/MM)

Llogaritja ditore e normës së likuiditetit

Nr.	Emërtimi	Shuma në datën
A	ASETET LIKUIDE (A1+A2+A3+A4+A5+A6+A7+A8)	
A1	Paraja e gatshme në arkë	
A2	Paraja në llogaritë rrjedhëse në banka dhe institucione tjera financiare	
A3	Depozitat pa afat si dhe depozitat tjera (përfshirë interesin nga këto depozita) në banka dhe institucione tjera financiare me maturitet të mbetur deri në 14 ditë	
A4	Të arkëtueshmet në llogari kliringu, të cilat duhet të paguhen brenda 14 ditë	
A5	Pjesa e papërdorur e kredive bankare të aprovuara për siguruesin të cilat mund të disponohen brenda 14 ditë	
A6	Letra me vlerë të emtuara Qeverisë së Republikës së Kosovës, qeveritë qendrore dhe bankat qendrore të vendeve të huaja (përfshirë interesat nga këto letra me vlerë), të cilat mund të konvertohen në para të gatshme brenda 14 ditëve kalendarike;	
A7	Letrat me vlerë të tregtueshme (përfshirë interesat nga këto letra me vlerë), me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut, të barasvlershëm me vlerësimin e S&P jo më pak se AA- si dhe të cilat mund të konvertohen në para të gatshme brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve kalendarike	
A8	Letrat me vlerë të klasifikuar si të mbajtura deri në maturim që kanë afat maturimi deri në 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike.	
B	DETYRIME TË MATURUARA: (B1+B2+B3+B4+B5+B6+B7+B8)	
B1	Detyrime që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimit (B1.1 deri në B1.5)	
B1.1	<i>Detyrime që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, të maturuara</i>	
B1.2	<i>Detyrime që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe bashkësigurimit, me afat maturimi deri në 14 ditë</i>	
B1.3	<i>Detyrime për honorare dhe shpërblime, të maturuara</i>	
B1.4	<i>Detyrime për komisionet e ndërmjetësimit me afat maturimi deri në 14 ditë</i>	
B1.5	<i>Detyrime të tjera nga veprimtaria direkte e sigurimit, të maturuara</i>	
B2	Detyrime nga aktiviteti i investimeve, të maturuara	
B3	Detyrime nga aktiviteti i investimeve, me afat maturimi deri në 14 ditë	
B4	Detyrime ndaj kreditorëve, të maturuara	
B5	Detyrime ndaj kreditorëve, me afat maturimi deri në 14 ditë	
B6	Detyrime ndaj punonjësve, të maturuara	
B7	Detyrime ndaj punonjësve, me afat maturimi deri në 14 ditë	
B8	Detyrime të tjera që janë maturuar ose kanë afat maturimi deri në 14 ditë	
C	Norma e likuiditetit (A/B)	

Vendi, data:

Përgatitur nga (emër, mbiemër):

Nënshkrimi:

Personi përgjegjës (emër, mbiemër):

Nënshkrimi dhe vula: